



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.03.2022)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:35 dhe mbaroi në orën 15:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

2. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, relator z. Klodian Kurushi.¹

Çështja e cila është për trajtim sot në rendin e ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi.

Fillimisht zoti Kurushi relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë;

B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

I. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

II. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Shkodër; Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtari për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhet, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë në përbërje të Kolegjit Zgjedhor, që është thirrur në detyrë, referuar nenit 149/2 të Kodit Zgjedhor, konkretisht: Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...} (këto tre gjyqtare në të njëjtën kohë kanë dhe pengesë ligjore në gjykimin e çështjes).

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit.

Në relacion është edhe lista përkatëse e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për të marrë pjesë në short.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Irida Kacerja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, seksioni penal.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në këtë rast të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z. Sokol Shehu, pasi përjashtimi i tij do të bënte të pamundur hedhjen e shortit, duke qenë se në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodrës figurojnë në detyrë katër gjyqtarë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Sokol Shehu (relator) dhe Arbër Çela dhe Hasan Selimi (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e transferuar përkohësisht pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht: Z. Bevis Shehaj.

Në shortimin e çështjes përkatëse sipas specifikimit në pjesën e parë të relacionit, të përjashtohet nga shorti gjyqtari i transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, që ka pengesë ligjore, konkretisht: {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, 2 dhe 3, gjyqtari Hazbi Balliu.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, duke përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit.

Gjyqtari për 1 çështje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhet, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (lista e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet është bashkëlidhur në relacion).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë në përbërje të Kolegjit Zgjedhor, që është thirrur në detyrë, referuar nenit 149/2 të Kodit Zgjedhor, konkretisht: {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përshtirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Valbon Çekrezi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Florjan Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, 8 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Në shortimin e çështjeve të veçanta, përjashtohet nga shorti gjyqtarët z. Sokol Ngresi dhe znj. Margarita Buhali, sipas përcaktimit në relacion, duke qenë se kanë pengesë ligjore.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtarët Margarita Buhali (relatore), Genti Dokollari dhe Laurent Fuçia (anëtarë).

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarët Genti Dokollari (relator), Margarita Buhali dhe Laurent Fuçia (anëtarë).

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Margarita Buhali dhe Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtar Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtar Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 7, civile, gjyqtarët Margarita Buhali dhe Genti Dokollari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Korçë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës

së Apelit Korçë, konkretisht: Znj. Arta Duka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, 2, 3, gjyqtari Dritan Hasani.

Ndërkohë nga ana e relatorit trajtohet edhe një kërkesë tjetër nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë, parashtruar në një relacion më vete.

Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata e Apelit Vlorë me shkresën nr. {...} prot., datë 18.03.2022 ka bërë me dije se “...në kushtet kur pranë Gjykatës së Apelit Vlorë është emëruar gjyqtar {...} dhe trupi gjykues mund të plotësohet me këtë gjyqtar, kërkojmë mosmarrjen në shqyrtim nga ana juaj të kërkesave për të cilat kemi kërkuar delegim për një gjyqtar, bashkëlidhur dhe kërkesa sipas të dhënave të mësipërme.”.

Për rrjedhojë, nevoja për kërkesën si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, aktualisht nuk ekziston më, pasi nevoja për caktimin e 1 gjyqtari në çështjen konkrete është plotësuar përmes pjesëmarrjes në këtë gjykim të gjyqtarit {...}.

Në këto kushte, kërkesa si më lart e Gjykatës së Apelit Vlorë tashmë ka mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Ndërsa sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për

çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Kurse sipas nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 20.12.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve.

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord me propozimin e Komisionit.)

Me kaq mbyllet procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor